




FLET PËR "EPOKËN E RE", AGIM KRASNIQI

FAQE 4-5

Javën e ardhshme fillon ekzekutimi i mjeteve për bizneset private

Zëvendësministri i Financave dhe Transfereve, Agim Krasniqi, ka thënë se në javën e ardhshme do të fillojë ekzekutimi i mjeteve në xhirlogaritë e bizneseve private nga shuma 60 milionë euro që është ndarë për subvencionimin e pagave për sektorin privat nga Qeveria e Kosovës. "Ne kemi formuar një komision që brenda dy ditësh do t'i identifikojë kompanitë që nuk janë përfituese dhe që kanë të bëjnë me tregun e rregulluar. Do të thotë, bizneset që kanë treg të rregulluar dhe të cilat verifikohen përmes listës në ATK do të përjashtohen dhe ky komision duhet ta përfundojë punën brenda kësaj jave. Besoj se javën tjetër do të fillojë dhe do të përfundojë ekzekutimi i mjeteve, pasi më nuk ka nevojë për të aplikuar", ka thënë Krasniqi



KOSNETTI: TË SHFRYTËZOHET PËRKUSHTIMI I SHBA-së DHE I BE-SË PËR KOSOVËN DHE SERBINË



Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka vlerësuar se qeveria amerikane dhe BE-ja janë vërtet të fokusuar në Ballkanin Perëndimor. Ai ka thënë se Kosova dhe Serbia, në procesin e dialogut për

normalizim të marrëdhënieve, duhet ta shfrytëzojnë këtë çast. Sipas tij, nëse Kosova dhe Serbia i marrin seriozisht zotimet e marrëveshjes së nënshkruar në Uashington, do të ketë përparime

FAQE 3

ZEMAJ,
QYTETARËVE:
RESPEKTOJINI
MASAT KUNDËR
COVIDIT!

FAQE 7



REÇICA KËRKON MË SHUMË
VËMENDJE SHOQËRORE NDAJ
TË MOSHUARVE

F. 9

KRYEMINISTRI HOTI: KEMI
PROGRAM MBËSHETËS PËR
KOMUNITETET JOSHUMICË

F. 9

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht-Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

SPORT

TRI HUMBJET E LLAPIT NUK
E RREZIKOJNË KARRIGEN
E BATATINËS

F. 13

Mbrojtja kërkon lirimin me kusht të Gucatit

HAGË, 1 TETOR - Zyra e Prokurorit të Specializuar në Hagë ka njoftuar se ka ndërmend që brenda 30-ditësh të ngrehë aktakuzë për kryetarin e Organizatës së Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Hysni Gucati, i cili dyshohet se ka penguar drejtësinë, ndërkaq mbrojtja e tij kërko lirim me kusht.

Gjatë paraqitjes së parë para gjykatës së Dhomave të Specializuara, gjyqtari i procedurës paraprake, Nicolas Guillou, ka thënë se mbrojtja e Gucatit ka parashtruar katër ankesa me shkrim për ta kundërshtuar legjitimitetin e arrestimit dhe transferimit të Gucatit në paraburgim në Hagë.

Gjyqtari kërko nga Zyra e Prokurorit të Specializuar që deri më 2 tetor t'u përgjigjen këtyre kërkesave të mbrojtjes. "Prokuroria e Specializuar ka ndërmend ta dorëzojë aktakuzën brenda një periudhe 30 ditore", ka pohuar prokurorja Valeria Bolici.

Avokati i Gucatit, Jonathan Reese, kërko lirim me kusht të klientit të tij, duke paraqitur një sërë kushtesh që kreu i OVL të UÇK-së do të respektonte,



nëse gjykata do të pranonte një gjë të tillë. Ndër të tjera, avokati Reese përmendi edhe një garanci prej 5 000 eurosh, që Gucati të jetojë në një adresë të caktuar në Kosovë dhe të raportojë në policinë e EULEX-it.

Por, Zyra e Prokurorit të Specializuar tha se mbetja në paraburgim e Gucatit është e nevojshme pasi "ka motive" se ai mund t'i "shmang

drejtësisë", por edhe të përsërisë veprat të cilat dyshohet se i ka kryer.

Gucati, sipas fletarrestimit të lëshuar nga Dhomat e Specializuara, dyshohet për pengim të drejtësisë, përkatësisht "për frikësim të dëshmitarëve, hakmarrje dhe shkelje të fshehtësisë së procedurës".

Gucati u arrestua në Prishtinë më 25 shtator nën dyshimet

për pengim të drejtësisë. Ai u arrestua në zyrat e OVL të UÇK-së, në kohën kur Zyra e Prokurorit të Specializuar kreu bastisje në këto zyra. Po të njëjtën ditë u arrestua edhe nënkryetari i kësaj organizate, Nasim Haradinaj, i cili dyshohet se ka penguar drejtësinë.

Tri herë radhazi OVLUÇK-ja mbajti konferenca për media ku u shpërndanë materiale që

pretendohet se janë dokumente konfidenciale të Gjykatës Speciale.

Përmbajtja e këtyre dokumenteve është e panjohur dhe ende nuk është konfirmuar nëse ato janë autentike.

Nënkryetari i OVLUÇK-së, Nasim Haradinaj, më 29 shtator ka bërë paraqitjen e tij të parë para Dhomave të Specializuara. Mbrojtja e tij kërko lirim e menjëhershëm të Haradinajt nga paraburgimi, ndërkaq Zyra e Prokurorit të Specializuar tha se shumë shpejt do të bëjë gati aktakuzën ndaj Haradinajt.

Dhomat e Specializuara dhe Zyra e Prokurorit të Specializuar, që ndryshe njihen edhe si Gjykata Speciale, kanë selinë në Hagë dhe merren me hetimin e krimeve të supozuara të luftës të pjesëtarëve të ish-Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Më 24 shtator Gjykata Speciale ka bërë arrestimin e parë në Kosovë. Ish-eprori i UÇK-së, Salih Mustafa, është personi i parë që u arrestua dhe u transferua në Hagë. Ndaj tij është ngritur aktakuzë për krime lufte. Gjatë paraqitjes së parë para gjykatës, Mustafa nuk është deklaruar nëse e ndien veten të pafajshëm apo fajtor për akuzat që rëndojnë ndaj tij.

Nënshkruhet marrëveshja Itali - Kosovë për zhvillimin e arsimit parashkollor

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Në Ministrinë e Arsimit, në prani të ministrit Ramë Likaj dhe ambasadorit të Italisë, Nicola Orlando, të enjten është organizuar ceremonia e nënshkrimit të marrëveshjes së bashkëpunimit në sektorin e edukimit parashkollor me OJQ-në italiane "Vullnetarët në Botë RTM".

Marrëveshja është pjesë e projektit Pedakos - Preschool Education Development Alliance for Kosovo, financuar nga Agjencia Italiane për Bashkëpunim Zhvillimor. Projekti do të zgjasë tri vjet dhe ka një vlerë totale prej 970 000 eurosh me një kontribut nga Kooperacioni Italian prej 905 333 eurosh.

Projekti është rezultat i bashkëpunimit mes Kooperacionit Italian, Pedakos, nga pala italiane, dhe Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Institutit Pedagogjik i Kosovës,

Universitetit të Prishtinës, nga pala e Kosovës, me kontributin e tri organizatave jofitimprurëse, OJQ-të e Childproof, Botanka dhe Shpresa dhe Jeta.

Qëllimi është të ndihmohen institucionet e Kosovës në zbatimin e Planit Strategjik të Arsimit të Kosovës 2017-21 për arsimin parashkollor (0-5 vjet), duke përmirësuar cilësinë e shërbimeve arsimore të ofruara nga shkollat për parashkollorët. Nënshkrimi i marrëveshjes do ta mundësojë (1) forcimin e aftësimit profesional të stafit parashkollor; (2) ndarja e praktikave të mira dhe ndërhyrjet e rikualifikimit në 15 shkolla pilot përmes përfshirjes së drejtpërdrejtë të ekspertëve italianë (pedagogë, arkitektë, mësues); dhe (3) zhvillimin e partneriteteve më efikase publik-private, përfshirë ndihmën e Ministrisë së Arsimit për të rimëkëmbur Këshillin Kombëtar të



Institucioneve Parashkollore. Ministri i Arsimit, Ramë Likaj, foli për nismën, duke konfirmuar gatishmërinë e tij edhe për bashkëpunime të radhës. "Ne si MASH jemi mbështetës dhe shumë optimistë që ky projekt do të udhëhiqet në mënyrën më të mirë. Përfitues fillestarë do të jenë gjithsej 15 institucione

parashkollore, publike, private dhe ato me bazë në komunitet. Mbi bazën e raportimit të pilotimit të këtij projekti do ta vazhdojmë shtrirjen edhe në institucione të tjera parashkollore", ka thënë ai. Ambasadori i Italisë në Kosovë, Nicola Orlando, ka theksuar rëndësinë e projektit, duke konsideruar se forcimi i

kapacitetit, për t'u siguruar të rinjve arsimin më të mirë të mundshëm, është thelbësor për të krijuar mundësi gjithnjë e më të mira për brezat e ardhshëm. "Italia ka përvojë të gjerë në sektorin pedagogjik dhe ne jemi të nderuar që jemi në gjendje t'i ndajmë praktikat tona të mira dhe njohuritë tona në këtë sektor me institucionet e Kosovës", ka thënë ai.

Ambasadori konfirmoi angazhimin e Italisë për t'i mbështetur rrugët arsimore nga fëmijëria e deri në specializimet pasuniversitare, sidomos në këtë fazë të vështirë të pandemisë.

Ndërkaq Federica Arezzi, koordinatore e Pedakos për RTM, ka theksuar se falë Pedakos-it, Kooperacioni Italian u ofron institucioneve dhe shkollave në Kosovë një mundësi unike të shkëmbimit me një përsosmëri italiane të njohur globalisht në sektorin e arsimit.

Ambasadori i ShBA-së në Kosovë, Philip Kosnett, ka mbajtur një konferencë virtuale për media

Kosnetti: Të shfrytëzohet përkushtimi i ShBA-së dhe i BE-së për Kosovën dhe Serbinë

Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka vlerësuar se qeveria amerikane dhe BE-ja janë vërtet të fokusuar në Ballkanin Perëndimor. Ai ka thënë se Kosova dhe Serbia, në procesin e dialogut për normalizim të marrëdhënieve, duhet ta shfrytëzojnë këtë çast. Sipas tij, nëse Kosova dhe Serbia i marrin seriozisht zotimet e marrëveshjes së nënshkruar në Uashington, do të ketë përparime

“Epoka e re”

PRISHTINË, 1 TETOR - Ambasadori amerikan në Kosovë, Philip Kosnett, ka thënë se raportet dhe partneriteti ndërmjet Shteteve të Bashkuara dhe Kosovës janë të forta. Në një konferencë virtuale për media, ai ka vlerësuar se është e rëndësishme të mos mendohet që këto raporte mes Uashingtonit dhe Prishtinës do të vazhdojnë përgjithmonë. “Është e natyrshme që marrëdhëniet tona do të evoluojnë dhe ju duhet të prisni që në të ardhmen, Kosova do të bëhet më e pavarur ekonomikisht dhe më pak e varur nga ndihma amerikane, nga ndihmat e diasporës apo të të huajve në përgjithësi”, ka deklaruar Kosnett.

Ai ka thënë se ShBA-ja e ka ndihmuar Kosovën dhe do të vazhdojë ta ndihmojë që të pavarësohet ekonomikisht, të jetë vend më i sigurt dhe të ketë më shumë barazi politike. “Ne jemi në një kohë kur qeveria amerikane dhe miqtë tanë në BE janë vërtet të fokusuar në Ballkanin Perëndimor, që të bëhet përparim në këtë rajon. Mund t’ju them se ka mbështetje të dy partive në ShBA për këtë

gjë, por nuk mund t’ju premtoj se energjia aktuale dhe përkushtimi do të vazhdojnë përgjithmonë. Është e rëndësishme që të shfrytëzohet ky moment”, është shprehur ai. Ambasadori amerikan ka vlerësuar se ndryshimi eventual i administratës amerikane pas zgjedhjeve presidenciale më 3 nëntor nuk do të ndryshojë asgjë sa i përket normalizimit ekonomik ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ai ka bërë me dije se për pavarësinë e Kosovës, zhvillimin dhe stabilitetin rajonal ka mbështetje nga të dyja partitë amerikane.

Duke folur për dialogun Kosovë - Serbi, Kosnett ka thënë se ShBA-ja nuk mendon se mund të ketë paqe të qëndrueshme dhe zhvillim ekonomik në këtë rajon, nëse çështjet ekonomike dhe politike trajtohen ndarazi. “Ne e mbështesim këtë proces (dialogu i Brukselit) dhe besoj se është e rëndësishme që të vazhdohet në mënyrë paralele me iniciativën që qeveria ime ka ndërmarrë, që të fokusohemi në iniciativa ekonomike, të cilat do ta përmirësojnë jetën e qytetarëve të Kosovës dhe Serbisë”, ka deklaruar Kosnett. I pyetur nëse çështja e themelimit të asociacionit të



komunave me shumicë serbe duhet të diskutohet sërish nga Kosova dhe Serbia, Kosnett ka vlerësuar se kjo çështje hyn në kuadër të procesit të udhëhequr nga Bashkimi Evropian, ku partnerët e BE-së dhe qeveritë, e Kosovës dhe Serbisë, i prijnë procesit. “Unë nuk do të komentoj për specifikat e çështjeve, për të cilat po diskutohet në procesin e

udhëhequr nga BE-ja”, ka shtuar ambasadori amerikan.

Diplomati amerikan ka thënë se nëse Kosova dhe Serbia marrin seriozisht zotimet e Uashingtonit do të ketë përparime. “Ne e dimë se do të duhet kohë që përparimi i vërtetë të jetë i dukshëm për shumë çështje për të cilat palët janë pajtuar në Uashington. Ne nuk mund të presim që

autostradat dhe linjat hekurudhore të ndërtohen brenda natës. Palët janë pajtuar se është më mirë që të lirohen nga presioni politik, nga drama politike, të marrin frymë, të themi nga procesi i mbushur me tensione, dhe brenda një viti të fokusohemi në çështjet ekonomike. Çfarë presim që të ndodhë pas një viti? Ne jemi të bindur se nëse dy qeveritë, e Kosovës dhe e Serbisë, i marrin seriozisht këto zotime, ne do të shohim përparim të madh gjatë kësaj periudhe”, ka deklaruar ambasadori amerikan.

Sa iu përket Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar nuk iu ka skaduar mandati, ai ka deklaruar se qëndrimi i qeverisë amerikane është se Gjykata Speciale është një institucion i rëndësishëm dhe i pavarur. “Dhomat janë institucion i Kosovës dhe duhet t’iu lejohej që të punojnë pa pengesa”, ka deklaruar Kosnett.

Hoti: Dialogu me Serbinë nuk do të ngecë për shkak të Kosovës

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka bërë me dije se Kosova nuk do të bëjë kompromise për ta arritur marrëveshjen finale me Serbinë. Ai ka thënë se dialogu i Brukselit për normalizim të marrëdhënieve Kosovë - Serbi nuk do të ngecë për shkak të Kosovës. “Asociacioni është një temë e kryer, e përmbyllur

në vitin 2013. Por, dialogu nuk do të ngecë për shkak të Kosovës. Jemi shtet i pavarur, parimet i kemi të qarta, të dakorduara me miqtë tanë ndërkombëtarë. Mbi bazën e këtyre parimeve jemi të gatshëm për dialogun”, ka deklaruar të enjten Hoti, pas inaugurimit të një rruge në Prizren.

Osmani pret në takim Avokatin e Popullit, ia dhuron Kushtetutën



PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit të Kosovës, Vjosa Osmani, ka pritur të enjten në takim Avokatin e Popullit, Naim Qelaj. Me këtë rast, Osmani e ka uruar Qelajn për detyrën e re, duke i dëshiruar sukses në punë. Osmani ka potencuar rëndësinë e bashkëpunimit ndër-institucional në mes të Kuvendit dhe Avokatit të Popullit, duke siguruar se Kuvendi do të jetë çdoherë i gatshëm për ta vazhduar

bashkëpunimin mes të dy institucioneve në nivelet më të larta. Ajo i bëri thirrje Avokatit të Popullit që t’i kushtojë vëmendje të posaçme barazisë gjinore dhe mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut në tërësi.

Ndërsa Qelaj falënderoi Kuvendin për besimin e dhënë në përzgjedhjen e tij, duke u shprehur se do të punojë për avancim të mëtutjeshëm në punën e Institucionit të Avokatit të Popullit. Ai përgëzoi

Kuvendin për miratimin e amendamentit kushtetues lidhur me Konventën e Stambollit, duke e cilësuar si marrje të përgjegjësisë konkrete për ta parandaluar dhunën në baza gjinore.

Në fund të takimit, kryetarja Osmani i dhuroi Avokatit të Popullit një Kushtetutë, si thirrje për t’u angazhuar në mbrojtjen e vlerave dhe të drejtave fundamentale që i garanton akti më i lartë juridik i vendit tonë.



Flet për “Epokën e re”, Agim Krasniqi

JAVËN E ARDHSHME FILLON EKZEKUTIMI I MJETEVE PËR BIZNESET PRIVATE

Zëvendësministri i Financave dhe Transfereve, Agim Krasniqi, ka thënë se në javën e ardhshme do të fillojë ekzekutimi i mjeteve në xhironlogaritë e bizneseve private nga shuma 60 milionë euro që është ndarë për subvencionimin e pagave për sektorin privat nga Qeveria e Kosovës. “Ne kemi formuar një komision që brenda dy ditësh do t’i identifikojë kompanitë që nuk janë përfituese dhe që kanë të bëjnë me tregun e rregulluar. Do të thotë, bizneset që kanë treg të rregulluar dhe të cilat verifikohen përmes listës në ATK do të përjashtohen dhe ky komision duhet ta përfundojë punën brenda kësaj jave. Besoj se javën tjetër do të fillojë dhe do të përfundojë ekzekutim i mjeteve, pasi më nuk ka nevojë për të aplikuar”, ka thënë Krasniqi

EPOKA E RE

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 1 TETOR - Agim Krasniqi, zëvendësministër në Ministrinë e Financave dhe Transfereve, ka thënë se punëtorët nuk do t’i marrin në mënyrë direkte mjetet që ka ndarë qeveria për bizneset private në shumën 60 milionë euro. Ai ka treguar se këto mjete do të derdhen në llogari të firmave në mënyrë që të subvencionohen pagat që i ka

pasur biznesi për punëtorët në dhjetor, kurse nëse është ndërmarrje e re, atëherë subvencionimi vlen nga korriku i këtij viti.

“Epoka e re”: Z. Krasniqi, kur pritët subvencionimi i pagave për punëtorët e sektorit privat? **Saktësisht, kur do të dalin mjetet?** **Krasniqi:** Së pari të sqarojmë. Punëtorët nuk do t’i marrin në mënyrë direkte këto mjete, por këto mjete vendosen në

ndërmarrje private, në llogari të firmës, në mënyrë që të subvencionohen pagat që i ka pasur biznesi për punëtorët në dhjetor, nëse është ndërmarrje e re, atëherë subvencionimi vlen nga korriku i këtij viti. Qëllimi është se me vendosjen e këtyre mjeteve në një ndërmarrje, i mundësojmë ndërmarrjes që t’i ruajë punëtorët që ka. Prandaj i jepet një mundësi ndërmarrjes që ka probleme me likuiditet dhe pagesë të pagave, pra kjo do të

jetë ndihmë direkte për ndërmarrjet. Ta kemi të qartë se procedura nuk është si herën e kaluar, kur ishte mundësia për t’u vendosur a do të shkojnë paratë nëpër ndërmarrje apo nëpër llogaritë e punëtorëve. Pra, në këtë rast paratë shkojnë në llogari të ndërmarrjes. E dyta që është me rëndësi, nuk do të ketë nevojë për aplikime pasi listat do të merren nga ATK-ja dhe mbi bazën e këtyre listave të verifikuara nga ATK-ja, aq sa ndërmarrja ka pasur punëtorë, aq do të subvencionohet. Ne kemi formuar një komision që brenda dy ditësh do t’i identifikojë kompanitë që nuk janë përfituese dhe që kanë të bëjnë me tregun e rregulluar. Do të thotë, bizneset që kanë treg të rregulluar dhe të cilat verifikohen përmes listës në ATK do të përjashtohen dhe ky komision duhet ta përfundojë punën brenda kësaj jave. Besoj se javën tjetër do të fillojë dhe do të përfundojë ekzekutimi i mjeteve, pasi më nuk ka nevojë për të aplikuar.

“Epoka e re”: Ka pasur shumë ankesa në drejtim të pronarëve që kanë marrë mjete, por nuk i kanë paguar sërish punëtorët. A do të ketë, në këto raste, verifikim nga shteti?

Krasniqi: Nga pakoja e parë kanë mbetur kriteret e paqarta, ndërsa kjo pjesa e 60 milionëshit është shumë e qartë dhe s’ka dykuptueshmëri. Mjetet do të shkojnë në llogari të punëdhënësit si ndihmë, si subvencionim pagash për punëtorët të cilët ai i ka të punësuar. Kjo nuk është pagë shtesë, por është subvencionim për paga. Nëse flisni për pakon emergjente, atëherë ka pasur mundësi që një ndërmarrje në muajin e parë t’ua bartë mjetet punëtorëve, kurse në muajin e dytë i ka paguar punëtorët dhe pastaj është bërë pagesa, por ajo çfarë po mungon është komunikimi në mes të punëdhënësit dhe punëtorëve. Punëdhënësit duhet t’ua sqarojnë punëtorëve se pjesën e



dytë të Pakos Emergjente mjetet janë derdhur mbi bazën e kërkesës së punëdhënësve dhe jo punëtorëve. Kësaj radhe s'do të ketë më këso gjërash. Saktë, mjetet shkojnë për punëdhënësin ose ndërmarrjen.

“Epoka e re”: Si do të bëhet kategorizimi i këtyre mjeteve?

Krasniqi: Pasi të përjashtohen kompanitë e rregulluara do të dihet saktësisht që prej 92 000, diku 93 000 bizneseve sa janë aktive. Do të dihet saktë sa do të jetë numri i punëtorëve. Maksimumi që ne i kemi të dhënat nga ATK-ja në sektorin privat janë 236 000 të punësuar, por kur t'i përjashtojmë këto ndërmarrje atëherë ky numër do të bjerë. Në momentin që komisioni na tregon saktë sa është nuri i punëtorëve, atëherë 60 milionëshi pjesëtohet me atë numër të punëtorëve dhe pagesa do të bëhet menjëherë dhe do të vendoset nëpër llogari të bizneseve.

“Epoka e re”: Z. Krasniqi, bizneseve do t'u ndahen mjetet për kokë punëtori apo si?

Krasniqi: Kur të shikohet numri i saktë se sa punëtorë do të jenë. Supozojmë se do të jenë 200 000 punëtorë, atëherë 60 milionëshi pjesëtohet me 200 mijë dhe caktohet sa do të jetë shuma për individ. Po e supozojmë se do të jetë 300 euro, atëherë një kompani që i ka 100 punëtorë do t'i marrë 30 000 euro, kurse kompania që ka pesë punëtorë i bie t'i marrë 1 500 euro.

Përkujtohet protesta e 1 tetorit e vitit 1997

Protesta e 1 tetorit shënoi kthesë në proceset politike

Përfaqësuesit institucionalë dhe politikë të Kosovës e kanë vlerësuar lart ndikimin e protestës së 1 tetorit të vitit 1997. Në 23-vjetorin e kësaj proteste ata kanë thënë se kjo protestë ishte frymëzim për mobilizim gjithëpopullor në luftën çlirimtare për liri të Kosovës

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 1 TETOR - Udhëheqësit institucionalë dhe partiakë në Kosovë e kanë përkujtuar protestën e 1 tetorit të vitit 1997. Ata e kanë vlerësuar lart ndikimin e kësaj ngjarjeje në proceset e mëvonshme politike. Në 23-vjetorin e kësaj proteste ata kanë deklaruar se kjo protestë e studentëve ka shënuar një kthesë në proceset politike.

Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se kjo lëvizje studentore është një inspirim i pashtershëm për gjeneratat e reja. “Në këtë përvjetor dua t'i uroj studentët për fillimin e vitit në të gjitha universitetet publike dhe private. Më 1 tetor 1997, ne dolëm në rrugë për ta kërkuar kthimin e studentëve shqiptarë në objektet e Universitetit të Prishtinës, protesta këto që shënuan kthesë në proceset politike në vend dhe ishin frymëzim për mobilizim gjithëpopullor në luftën tonë të drejtë për liri, pavarësi dhe demokraci. Kjo lëvizje studentore është një inspirim i pashtershëm për gjeneratat e reja, për një Kosovë demokratike, të zhvilluar ekonomikisht dhe me prosperitet”, ka shkruar Hoti në profilin e vet në “Facebook”.

Lideri i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, i cili ishte një ndër udhëheqësit e kësaj proteste, ka thënë se gjenerata e studentëve e 1 tetorit 1997 janë të rinjtë e kohëve të zymta të apartheidit. “Që atëherë, çdo 1 tetor kujtojmë ditën kur 20 mijë studentë në Kosovë, të veshur në të bardha, me parulla si ‘Merrni frymë sikur ne’, ‘Lirim i pakusht i objekteve universitare!’ dhe ‘E nesërmja flet sot, nesër vonë!’ marshuan për të kërkuar lirimin e ndërtesave dhe hapësirës universitare nga regjimi i atëherëshëm serb. Çdo 1 tetor përkujtojmë intelektualin që na priu në protestat e 1997-s, rektorin e universitetit dhe akademikun e rezistencës që asnjëherë nuk u zmbrops, prof. Ejup Statovcin”, ka shkruar Kurti në profilin e vet në “Facebook”.

Këtë protestë e kanë përkujtuar edhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli dhe ai i AAK-së, Ramush Haradinaj. Ndërsa ish-lideri i Lëvizjes Studentore, Bujar Dugolli, ka thënë se në atë kohë



bota kishte kthyer vëmendjen në Kosovë, e cila me luftën e drejtë e ka fituar edhe përkrahjen dhe lirinë e munguar. “Para 23 vjetësh, më 1 tetor 1997, mediat dhe gazetarët e huaj raportonin nga Prishtina e Kosova për protestën e studentëve të Universitetit të Prishtinës, të cilët, të përkrahur nga profesorët dhe qytetarët anembanë vendit, kërkonin të drejtat e tyre themelore. Nga atëherë bota kishte kthyer vëmendjen në Kosovë, e cila me luftën e drejtë e fitoi edhe përkrahjen dhe lirinë e munguar. Kishte ardhur koha, duhej të bëhej kthesa jonë, në të njëjtën rrjedhë, koha, si rrallëherë në historinë tonë, punonte për ne, prandaj me shumë të drejtë poetja argentinase Evita Peron,

thoshte: ‘Koha është armiku më i madh’, ka shkruar Dugolli në llogarinë e vet në “Facebook”. Kurse Muhamet Mavraj, një nga ish-drejtuesit e Lëvizjes Studentore të '97-s, ka thënë se 1 tetori '97 ka parahistorinë e vet, duke marrë parasysh situatën e vështirë që ishte në atë kohë. “Tash po flasim për 1 tetorin e vitit 1997 dhe kjo, sikurse çdo zhvillim tjetër, nuk është ngjarje që i përket asaj dite që e futë në histori dhe bëhet datë e rëndësishme. Kjo e ka parahistorinë e vet, e cila është jashtëzakonisht shumë e vështirë në qoftë se marrim parasysh rrethanat, kushtet dhe okupimin që zhvillohej, veçanërisht vështirësitë e Universitetit të Prishtinës dhe vështirësitë e pafundme të studentëve”, ka thënë Mavraj në një

intervistë dhënë RTK-së në emisionin “Studio e hapur”, duke theksuar se fati i Kosovës ishte tërësisht i anashkaluar nga çfarëdo zgjidhje serioze e fatit të saj dhe perspektive të saj, për dallim nga njësitë e tjera të ish-Jugosllavisë. Mavraj ka thënë se 1 tetori '97 ishte një nga organizimet më të mira të kombit shqiptar. “Fuqia jonë ka qenë organizimi, i cili ka qenë në nivel, pra ka qenë i papërsëritshëm”, ka thënë ai. Mavraj ka shtuar se protesta e studentëve më 1 tetor '97 ka thyer mitin e frikës. “Ka zgjuar energji të fjetura të kombit shqiptar”, ka deklaruar Mavraj. Duke folur për kontributin e ish-rektorit Ejup Statovci për këtë ngjarje, Mavraj ka thënë se Ejup Statovci mbetet një rektor historik i Universitetit të Prishtinës.

Më 7 tetor fillon fushata ‘Kujdes në internet’


**EPOKA
ERE**

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 1 TETOR - Zëvendësministri i Punëve të Brendshme, Zafir Berisha, ka mbajtur të enjten takim me Këshillin Shtetëror për Siguri Kibernetike, ku janë diskutuar të arriturat dhe sfidat me të cilat janë ballafaquar institucionet që merren me siguri kibernetike. Në këtë takim u theksua progresi që është arritur në fushën e sigurisë

kibernetike. Po ashtu, u diskutua për Strategjinë Kundër Krimit Kibernetik, konkretisht për dinamikën e planit të veprimit të kësaj strategjie si dhe për hapat që po ndiqen për hartimin e projektligjit për siguri kibernetike. Në takim u theksua se tashmë Republika e Kosovës, respektivisht Ministria e Punëve të Brendshme, i është bashkëngjitur fushatës së ndërgjegjësimit për sigurinë kibernetike që fillon në muajin

tetor. Ministria e Punëve të Brendshme, me mbështetje të UNDP-së, gjatë këtij muaji do ta fillojë zyrtarisht fushatën “Kujdes në internet”. Fushata do të fillojë më 7 tetor, në të cilën do të organizohen disa aktivitete me qëllim të ndikimit dhe të njohjes së përparësive dhe rreziqeve që vijnë nga interneti. Po ashtu, do të publikohen edhe disa produkte mediale në funksion të fushatës.



Ministri Selimi, pjesë e takimit virtual për Kodin Civil dhe të bërit biznes



PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Ministri i Drejtësisë, Selim Selimi, me ftesë të Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë, sot ka marrë pjesë në forumin virtual në të cilin temë diskutimi ka qenë “Kodi Civil dhe të bërit biznes”. Pjesë e këtij takimi ishin dr. Kerstin Niethammer-Juergens, shefe e Projektit të Kodit Civil të financuar nga BE, Alfons Lentze, këshilltar për Politikën e Sundimit të Ligjit nga Zyra e BE-së në Kosovë dhe Haxhi Gashi, ekspert kryesor i Projektit të Kodit Civil. Duke folur për rëndësinë e Kodit Civil, ministri Selimi tha se ky kod ka ardhur si rezultat i punës dhe angazhimit të qeverisë,

përkatësisht Ministrisë së Drejtësisë, aktorëve relevantë të të gjitha institucioneve, përfaqësuesve të bizneseve, shoqërisë civile dhe përfaqësuesve vendorë dhe ndërkombëtarë. Kodi Civil është hartuar nga Ministria e Drejtësisë, me mbështetje të Bashkimit Evropian përmes një projekti të veçantë i cili është zhvilluar në dy faza. Kodi Civil i Republikës së Kosovës do të jetë i strukturuar në pesë libra, në të cilat do të përfshihen: 1. Pjesa e përgjithshme, 2. Detyrimet, 3. Pronësia dhe të drejtat e tjera sendore, 4. Familja dhe 5. Trashëgimia.

Osmani vizitoi Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Kryetarja e Kuvendit, Vjosa Osmani, për nder të Ditës Ndërkombëtare të të Moshuarve dhe në kuadër të projektit “Furnizimi me mjete mbrojtëse kundër Covid-19 për kategoritë e rrezikuara sociale”, ka vizituar Shtëpinë e të Moshuarve në Prishtinë. Osmani ka theksuar se një shtet shpërfaqë zhvillimin dhe emancipimin shoqëror atëherë kur tregon vëmendjen dhe kujdesin e nevojshëm për personat e moshuar. Në takim me të moshuarit u theksua nevoja për zgjerimin e rrjetit të shtëpive për të moshuar dhe në komunat e tjera. Osmani ka pohuar se sfida me pandeminë vuri në pah punën e madhe dhe rëndësinë e profesionit të mjekëve e të

infirmierëve. “Ishte lajm shqetësues përhapja e infeksionit në Shtëpinë e të Moshuarve, ndaj na gëzon fakti që e kaluat me lehtësi dhe pa raste fataliteti”, ka thënë kryetarja Osmani në takim me të moshuarit. Banorët e Shtëpisë së të Moshuarve shprehën falënderimin për mbështetjen institucionale, shpalosën kërkesat dhe rrëfyer pjesë të përditshmërisë së tyre, duke potencuar përkushtimin e profesionistëve shëndetësorë për ta. Projekti është mbështetur nga Kuvendi i Kosovës dhe Ambasada e Luksemburgut, ndërkuaq është realizuar nëpërmjet Shoqatës së të Drejtave të Pacientëve në Kosovë (PRAK).



Hyrja në oborrin e QKUK-së, sërish me para

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Qendra Klinike Universitare e Kosovës (QKUK) ka njoftuar se me fillimin e normalizimit të shërbimeve shëndetësore ka

rikthyer pagesat të laurat në hyrje-dalje. “Pas lirimit të tyre ka pasur numër të madh të qytetarëve që kanë shfrytëzuar hapësirat e parkingut në

QKUK, edhe pa pasur nevojë për kryerje të shërbimeve shëndetësore. Pas normalizimit të shërbimeve shëndetësore, është rritur numri i qytetarëve

dhe makinave që frekuentojnë hapësirat dhe parkingjet në QKUK dhe kjo ka vështirësuar qasjen”, është bërë me dije në njoftimin e QKUK-së.



Zemaj, qytetarëve: Respektojini masat kundër Covidit!



Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësuesit nga misioni i ekspertëve Covid-19 "Joint Robert Koch", të cilët i ka falënderuar për vizitën dhe për mundësinë që u kanë dhënë mjekëve të Kosovës që t'i ndajnë përvojat me ta. Zemaj në një konferencë për media ka thënë se institucionet e Kosovës kanë arritur që ta menaxhojnë pandeminë, duke u renditur ndër shtatë vendet e para me rezultatet më të mira në javët e fundit. Ai u ka bërë thirrje qytetarëve që t'i respektojnë edhe më tej me korrektësi masat kundër Covidit

EPOKA
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 1 TETOR - Ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj, ka pritur të enjten në takim përfaqësues nga misioni i ekspertëve Covid-19 "Joint Robert Koch" nga Gjermania, të cilët po qëndrojnë në një mision vlerësimi në Kosovë lidhur me Covid-19. Zemaj ka falënderuar ata për vizitën dhe për mundësinë që u kanë dhënë mjekëve të Kosovës që t'i ndajnë përvojat me ta. Ministri Zemaj ka pohuar se institucionet e Kosovës kanë arritur që ta menaxhojnë pandeminë, duke u renditur

ndër shtatë vendet e para me rezultatet më të mira në javët e fundit. Ai u bëri thirrje qytetarëve që t'i respektojnë edhe më tej me korrektësi masat kundër Covidit. "Për dy javë me vizitat e tyre në QKUK dhe spitale rajonale, në IKShPK janë duke marrë dhe duke trajtuar mënyrat e trajtimit të pandemisë dhe janë duke parë të gjitha kapacitetet, por edhe për shërbimet shëndetësore që jepen në Kosovë. Jam shumë i kënaqur me vlerësimin e tyre, për punën e profesionistëve shëndetësorë të organizmit tonë se si e kemi menaxhuar situatën", ka thënë ministri Zemaj. Ndërsa Jonathan Baum nga "Joint

Koch/EMT/GOARN - mission to Kosovo" ka lavdëruar punën e profesionistëve shëndetësorë, duke shtuar se ata rrezikuan edhe jetën për t'u dalë në ndihmë pacientëve. "Covid-19 nuk i respekton kufijtë, prandaj është e nevojshme që të qëndrojmë së bashku në këtë luftë. Ardhja jonë këtu tregon sa i rëndësishëm është bashkëpunimi për ta mposhtur këtë virus. Falënderoj ministrin dhe punëtorët shëndetësorë që janë përballur me këtë pandemi", është shprehur Baum. Ai ka thënë se stafi është i dedikuar dhe thjesht ata e kanë rrezikuar edhe jetën e tyre për ta shpëtuar jetën e të tjerëve. "Prandaj i falënderoj të

Dy të vdekur dhe 43 raste të reja me Covid-19

Gjatë 24 orëve të fundit në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) dhe laboratorët privatë me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 589 mostra të marra nga ShSKUK dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren, prej të cilëve rezultojnë 43 raste pozitive me Covid-19. Brenda 24 orëve janë raportuar dy raste të vdekjes me Covid (1 rast nga MIQ-COVID, QKUK dhe 1 rast nga Spitali i Prizrenit). Numri total i rasteve pozitive është 15 663 raste nga 68 463 persona të dyshimtë me këtë

virus dhe 627 raste të vdekjes. Gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 123 pacientë, kurse numri i përgjithshëm i të shëruarve deri më sot është gjithsej 13 677 raste, ndërsa numri i rasteve aktive është 1 359. Rastet pozitive janë nga komuna Prishtinë 15 raste, komuna Fushë-Kosovë 4 raste, komuna Prizren 4 raste, komuna Gjiçan 3 raste, komuna Mitrovicë 3 raste, komuna Podujevë 2 raste, komuna Skenderaj 2 raste, komuna Suharekë 2 raste, komuna Viti 2 raste dhe me nga një rast Drenas, Ferizaj, Gjakovë, Kamenicë, Lipjan dhe Vushtrri.

gjithë punëtorët shëndetësorë. U shpreh ngushëllime të gjithë atyre që kanë humbur jetën nga Covid dhe familjeve të tyre. Mjekët

mund të kryejnë punë në klinika, por ne jemi të obliguar t'u përmbahemi rregullave", ka deklaruar Baum.

Rektori Naser Sahiti fillon mandatin në krye të UP-së

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Të enjten ka filluar mandatin katërvjeçar në krye të Universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina", prof. dr. Naser Sahiti. Pas mikpritjes në Rektoratin e UP-së nga stafi i brendshëm i rektoratit, rektori Sahiti ka vizituar disa njësi akademike, ku i ka takuar

dekanët e fakulteteve të cilët, po ashtu, kanë nisur mandatin e tyre për menaxhimin e një-sive akademike. Rektori Sahiti e vizitoi së pari Fakultetin e Mjekësisë në UP, për t'i vazhduar vizitat në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike, Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe

Kompjuterike, Fakultetin e Arteve dhe Fakultetin Juridik. Gjatë vizitës në njësitë akademike të UP-së, rektori Sahiti u prit në takim nga dekanët: prof. dr. Suzana Manxhuka-Kërliu, dr. sc. Ahmet Shala, prof. asoc. dr. Isak Shabani, dr. Hazir Haziri dhe prof. ass. dr. Avni Puka.



Reçica kërkon më shumë vëmendje shoqërore ndaj të moshuarve

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë edhe me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, kanë vizituar të enjten Shtëpinë për Persona të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, për t'ua uruar banorëve të kësaj qendre këtë ditë feste. Reçica me këtë rast ka kërkuar më shumë vëmendje shoqërore ndaj moshës së tretë

EPOKA E RE**Albulena S. MAVRAJ**

PRISHTINË, 1 TETOR - Në Ditën Botërore të të Moshuarve, ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, bashkë edhe me ministrin e Shëndetësisë, Armend Zemaj, të enjten kanë vizituar Shtëpinë për Persona të Moshuar pa Përkujdesje Familjare në Prishtinë, për t'ua uruar

banorëve të kësaj qendre këtë ditë feste që, për fatin e keq, situata pandemike ka pamundësuar të organizohet dhe festohet ashtu siç vërtet e meritojnë të moshuarit tanë. Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, në një paraqitje për media ka thënë se vizita e sotme në këtë ditë të rëndësishme për këtë shtresë të respektuar të shoqërisë, që trajtohen dinjiteteshëm nga stafi

mbështetës i kësaj qendre, është në shenjë respekti, por edhe për ta sensibilizuar të gjithë shoqërinë për më shumë vëmendje ndaj moshës së tretë. “Ne si shtet dhe shoqëri duhet të bëjmë akoma më shumë për këtë kategori të qytetarëve dhe pikërisht ky është edhe misioni im si ministër i MPMS, pra për të bërë më të mirën e mundshme që këta bashkëqytetarë të kenë kushte dhe shërbime sa më të

mira jetese”, ka thënë Reçica. Gjithashtu, në këtë ditë të veçantë, që sot shënohet në gjithë botën, ministri i MPMS-së, Skender Reçica, ka vizituar edhe përfaqësuesit e Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës, të prirë nga kryetari Shaban Kajtazi, me të cilët ka bashkëbiseduar lidhur me të gjitha angazhimet e MPMS-së për jetësimin sa më parë të kërkesave shumë të drejta të pensionistëve. “Përfaqësuesve të Lidhjes së Pensionistëve të Kosovës i shpreha përsëri vendosmërinë dhe përkushtimin tim për miratimin sa më parë të të gjitha akteve ligjore të cilat ndikojnë në mirëqenien e të gjithë

qytetarëve, veçmas plotësimin ndryshimin e Ligjit për Skemat Pensionale të Shtetit, që i hap rrugë njohjes së stazhit të punës për punonjësit e larguar me dhunë gjatë viteve '90 nga pushteti serb”, ka thënë ministri Reçica.

Ministri Reçica ka thënë se si ministër i MPMS-së, në bashkëpunim edhe me institucione të tjera gjegjëse, janë duke u kujdesur që ta sigurojnë buxhetin e nevojshëm për të gjithë të moshuarit që janë të përfshirë nëpër skemat pensionale dhe sociale dhe, po ashtu, janë tejet të përkushtuar që të sigurojmë shërbime adekuate në qendrat e të moshuarve.



Pensionistët sërish obligohen të paraqiten në zyrat e pensioneve të MPMS-së

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) ka njoftuar pensionistët e Republikës së Kosovës të cilët kanë qenë të obliguar të lajmërohen në zyrat e pensioneve gjatë periudhës janar - 30 shtator 2020, e që për shkak të pandemisë

Covid-19 kanë qenë të liruar nga ky obligim, tani e tutje obligohen që të paraqiten në zyrat e pensioneve të MPMS-së. “Prandaj duke filluar nga data 1 tetor 2020 obligohen që të paraqiten në zyrat e pensioneve të MPMS në komunat ku ata jetojnë. Në të kundërtën, do të

veprohet sipas ligjeve që janë në fuqi, që do të thotë se ata pensionistë që kanë pasur të lajmërohen gjatë periudhës së lartcekur e nuk lajmërohen deri në fund të muajit tetor 2020, do të suspendohen nga pagesa”, thuhet në njoftimin e MPMS-së.



Kryeministri Hoti: Kemi program mbështetës për komunitetet joshumicë



REÇAN, 1 TETOR (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, i shoqëruar nga zëvendëskryeministri Driton Selmanaj dhe ministri i Infrastrukturrës, Arban Abrashi, ka vizituar të enjten komunitetin boshnjak në Reçan, ku është pritur nga qytetarët e kësaj zone dhe deputeti Rasim Demiri, i cili është kryetar i koalicionit VAKAT dhe shëf i Grupit Parlamentar 6+.

Fillimisht, kryeministri Hoti ka vizituar Shkollën Fillore të Mesme të Ulët "Meto Bajraktari", ku zhvillojnë mësimin nxënës të kësaj zone. "Për herë të parë, në Ministrinë e Arsimit ne do të themelojmë një divizion që do të merret vetëm me arsimin në gjuhën e komuniteteve", ka thënë kryeministri Hoti. Më tej, Hoti tha se është i rëndësishëm sidomos furnizimi me libra për

këtë komunitet, në mënyrë që të përmirësohen kushtet e jetës së të gjithë qytetarëve dhe komuniteteve në përgjithësi. Duke parë nga afër disa projekte infrastrukturore që janë duke u zhvilluar dhe janë financuar nga Qeveria e Kosovës, kryeministri Hoti premtoi se qeveria do t'iu qëndrojë afër qytetarëve të kësaj treve në përmirësimin e jetës së tyre, veçanërisht komunitetit

boshnjak dhe, në të njëjtën kohë, falënderoi këtë komunitet për kontributin që kanë dhënë në shtetndërtimin e Kosovës. Kryeministri Hoti tha se kanë ndarë edhe dy milionë euro si pjesë e rimëkëmbjes ekonomike vetëm për komunitetet joshumicë, për dy qëllime: për t'i ndihmuar bizneset që punësojnë punëtorë të komuniteteve joshumicë dhe

për t'i ndihmuar familjet që janë në kushte më të vështira nga këto komunitete, shtesë nga ato përfitime nga pakoja e rimëkëmbjes ekonomike, që përfitojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. "Gjithë programi i Qeverisë së Republikës së Kosovës ka një segment të fuqishëm të mbështetjes për komunitetet joshumicë", ka thënë kryeministri Hoti.

Amerikanët fillojnë bisedat për implementimin e 'Mini-Schengenit'



PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Pas marrëveshjes së nënshkruar për krijimin e grupit të përbashkët punues në mes të Odave Ekonomike të Kosovës dhe Serbisë, është mbajtur takimi i parë virtual ku është diskutuar për normalizimin ekonomik. Në njoftimin e lëshuar për media nga odat ekonomike është thënë se në këtë takim virtual është diskutuar për fuqizimin e bashkëpunimit dhe përpjekjet e përbashkëta për ta përkrahur zbatimin e aspekteve ekonomike

të marrëveshjes së nënshkruar. "Të dyja odat amerikane do të punojnë së bashku për t'i konsultuar anëtarësitë për t'i identifikuar barrierat e pazgjidhura në tregti dhe për t'i ofruar rekomandimet konkrete për zgjidhjen e tyre, si dhe për t'i sugjeruar masat për operacionalizimin e rajonit 'mini-schengen'. Po ashtu, të dyja odat amerikane janë pajtuar të promovojnë bashkërisht para kompanive amerikane mundësitë e investimeve në tërë

rajonin e Ballkanit Perëndimor", është thënë në njoftimin për media. Gjithashtu, është theksuar se odat amerikane do të punojnë së bashku për organizimin e forumeve investive dhe për ngritjen e vetëdijes së komunitetit të biznesit lidhur me mundësitë e financimit nga Korporata Ndërkombëtare Zhvillimore Financiare e Shteteve të Bashkuara (DFC), banka EXIM dhe agjencitë e tjera të ShBA-së.

Kuçi takohet me ambasadorin hungarez, bisedojnë për marrëveshjen financiare Kosovë - Hungari

PRISHTINË, 1 TETOR (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur të enjten në takim ambasadorin e ri hungarez në Kosovë, Jozef Bencze. Bashkë me ambasadorin ishin edhe Kristztina Szabo, atashe për marrëdhënie ekonomike dhe Mirdita Bicaj. Në mes të ambasadorit Bencze dhe min-

istrit Kuçi është diskutuar për marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve dhe marrëveshjet ndërkombëtare të Kosovës me Hungarinë. Biseda është zgjeruar në Marrëveshjen për Themelimin e Programit Kornizë për Bashkëpunim Financiar që pritet të ratifikohet së shpejti në Kuvendin e Kosovës. Kjo

marrëveshje e nënshkruar vite më parë, sipas ambasadorit Bencze, ka mbetur mbrapa në konkretizim. Ndërsa ministri Kuçi ka premtuar se realizimi i projekteve në fushën e ujërave do të lehtësohet nga Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit. "Projektet në Ferizaj, Deçan, Drenas dhe Gjakovë kanë rëndësi të veçantë dhe të



gjitha janë prioritet për qytetarët e këtyre komunave, që tashmë janë njoftuar", ka thënë Kuçi. Ambasadori Jozef

Bencze ka bërë me dije se më 13 tetor do të vijë në vizitë një delegacion i lartë nga qeveria hungareze.

Posta e Kosovës, e gatshme ta zgjerojë bashkëpunimin me Komunën e Drenasit

DRENAS, 1 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Drenasit, Ramiz Lladrovci, ka prituri në një takim u. d. kryeshefen ekzekutive të Postës së Kosovës, Vjollca Shala-Mulaj dhe zyrtarë të Postës së Kosovës. Takimi kishte karakter njoftues dhe me këtë rast kryeshefja Shala-Mulaj falënderoi kryetarin Lladrovci për bashkëpunimin e deritanishëm dhe diskutoi për mundësitë e zgjerimit të bashkëpunimit në fusha të rëndësishme, që prekin interesin e qytetarëve të Komunës së Drenasit. “Kam zgjedhur Drenasin si komunën e parë në vazhden e

vizitave të mia nëpër komuna për arsye se Drenasi është komuna me performancën më të mirë në Kosovë”, ka thënë Shala-Mulaj. Me këtë rast, ajo i dhuroi kryetarit Lladrovci një ekzemplar të filatelistë me pulla postare që për motiv kanë heronjtë Fehmi dhe Xhevë Lladrovci.

Kryetari Lladrovci falënderoi kryeshefen Shala-Mulaj për vizitën dhe gatishmërinë për bashkëpunim të ndërsjellë dhe me këtë rast ua dhuroi medaljonet e punuara nga gratë e Qendrës për Promovimin e Drejtave të Grave (QPDG) me seli në Drenas.



Haskuka shpërndan pako ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë



PRIZREN, 1 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Prizrenit, Mytaher Haskuka, së bashku me drejtorin e Drejtorisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale, Islam Thaqi, kanë vazhduar shpërndarjen e pakove ushqimore dhe higjienike për familjet në nevojë. Haskuka ka bërë me dije se gjatë kohës së pandemisë kanë pranuar gjithsej 4 000

kërkesa, ku në fazën e parë kanë shpërndarë rreth 1 750 pako për familjet në nevojë. “Ndërkaq në fazën e dytë vazhduam me shpërndarjen e 2 666 pakove, ku në total kemi mbështetur me pako emergjente mbi 5 000 familje. Në të njëjtën kohë, me qëllim të mbështetjes së ekonomisë vendore, jemi munduar që produktet e pakove ushqimore dhe higjienike të

përbëhen nga prodhimet vendore”, ka thënë kryetari Haskuka. Ai ka falënderuar gjithë donatorët vendorë dhe ndërkombëtarë për mbështetjen e ofruar gjatë kësaj periudhe. “Jemi të vendosur të qëndrojmë afër secilës familje të prekur nga pandemia. Bashkë, me solidaritet e humanizëm, kalojmë me sukses çdo sfidë para nesh”, ka thënë Haskuka.

Kryetari i Shoqatës Panshqiptare “Vatra” viziton Komunën e Skenderajt

SKENDERAJ, 1 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Skenderajt, Bekim Jashari, ka prituri në takim kryetarin e Shoqatës Panshqiptare “Vatra”, Elmi Berisha, së bashku me bashkëpunëtorë, me të cilët ka biseduar rreth bashkëpunimit për realizimin e projekteve të përbashkëta. “Pata nderin që në emër të familjes sime të pranoj një mirënjohje nga ‘Vatra’ për kontributin e komandantit leg-

jendar Adem Jashari dhe familjes Jashari për çlirimin e vendit”, ka thënë Jashari, i cili ka falënderuar kryetarin Berisha për angazhimin e tij dhe lobit shqiptar në ShBA në përkrahje të shtetit tonë. “Ishte konkluzion i përbashkët që shteti ynë nuk ka krijuar kushte të favorshme për investime ndërkombëtare dhe, për më tepër, pengesat burokratike po pengojnë zhvillimin ekonomik të shtetit tonë”, ka thënë Jashari.



Flamur Fetahaj emërohet nënkryetar i Komunës së Gjakovës

GJAKOVË, 1 TETOR (ER) - Kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, ka emëruar të enjten disa drejtorë në dikasteret e

caktuara dhe, po ashtu, ka emëruar edhe nënkryetarin e komunës. Sipas njoftimit të Komunës së Gjakovës, nënkryetar i komunës është

emëruar Flamur Fetahaj. Drejtor për Punë të Përgjithshme Administrative është emëruar Nikollë Lleshi, drejtoreshë për Shëndetësi

dhe Mirëqenie Sociale është emëruar Afërdita Spahiu-Shllaku, drejtor për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural është emëruar Haxhi Sejdiu,

drejtor për Punë Inspektuese është emëruar Edmond Dushi, dhe drejtor i Arsimit është emëruar Gjevan Nikollbibaj.

Fillon ndërtimi i trotuarit në fshatin Shkozë të Malishevës

MALISHEVË, 1 TETOR (ER) - Në kuadër të rregullimit të infrastrukturës së përgjithshme në vendbanimet e Komunës së Malishevës, të enjten në fshatin Shkozë ka filluar ndërtimi i trotuarit me gjatësi 500 metra, nga hyrja e fshatit në drejtim të shkollës. Në fillimin e punimeve ishin të pranishëm drejtori i Urbanizmit në Malishevë, Ahmet Morina dhe shefi i

Njësisë së Prokurimit Komunal, Nuhi Shala, të cilët janë takuar edhe me banorë të këtij fshati.

Drejtori i Urbanizmit, Ahmet Morina, ka bërë me dije se ndërtimi i këtij trotuari “është pjesë e projekteve kapitale dhe i planifikimeve komunale për këtë vit, ndërsa trotuari, i cili ka qenë edhe kërkesë e fshatit, fillon nga hyrja në fshat dhe shkon në drejtim të shkollës”.

“Krahas dhjetë rrugëve që jemi duke i rregulluar në Shkozë, sot ka filluar edhe realizimi i projektit të radhës, të trotuarit dhe gradualisht jemi duke i përmbushur kërkesat dhe nevojat e banorëve të Shkozës, sikur edhe në të gjitha vendbanimet e tjera”, ka thënë drejtori Morina, i cili edhe i ka uruar banorët për projektin e trotuarit që po realizohet në këtë fshat.



‘BACA SYLEJMON’, ME VLERA NJERËZORE FISNIKËSH

Shkruan: Major Asllan OSMANAJ, gazetar i luftës së fundit në Kosovë

Paraprakisht, strategjikisht që në pranverën e 1998-s ishte caktuar se porta e parë hyrëse e të dëbuarve të Kosovës ishte Tropoja, pastaj Hasi dhe e treta Kukësi. Parashikimin e vërtetoi fundi i majit, fillimi i qershorit e në vazhdimësi. Kur isha në garnizonin e Tropojës më rastiste që brenda 24 orësh, në vende të ndryshme, të takohesha disa herë me një person, që të ardhurit e thërrisnin: “Baca Sylejmon”. Një njeri i shkathët, i komunikueshëm dhe që gjithkujt i jepte zgjidhjen e duhur. Të dëbuarit hynin që nga Qafa e Dobërdolit duke kaluar bjeshkët e Junikut e të Tropojës për të zbritur nga Ara e Osës, Padeshi, fshatrat e Shipshanit, Kasaj, Kamenicë, Qafa e Pëllumbit, Bytyçi e që grumbulloheshin në qytetin e “Bajram Currit”. Dhe “Bacën Sylejmon” e kam takuar në pikat hyrëse, në komunat kufitare, në qendrat grumbulluese të qytetit dhe në oborret e çdo pallati ditën e natën. Në komunikim të vazhduar me funksionarët vendorë e qendrorë, me MCR-në, OSBE-në, UNCHR-në dhe gjithë organizatat ndihmuese nga shumë vende. Më bënë përshtypje se “statistikën” e kishte në kokë. Shpjegonte deri në hollësi, saktësisht për gjendjen komplekse të të ardhurve.

KUSH ISHTE KY “BACA SYLEJMON”?!

Relievi kodrinor dhe bjeshkor, bashkë me shtëpitë e kullat e Junikut, kanë harmonizuar

virtute ndjesish simbolike, si: besnikëri, trimëri, bujari, urti dhe qëndrueshmëri. Një nga kullat e ngurta, e tillë është kulla e Mon Pepshit në Junik, ku lindi më 1 tetor 1942 Sylejmon Pepshi. Me këto tradita u edukua gjithë jetës. Ajo kullë ka pritur e përcjellë njerëz me vlera. Ajo u bë bazë që me fillimet e UÇK-së. Sylejmoni i dhuroi luftës kamionin, traktorin dhe çfarë kishte që i nevojitej. Me rënien e Junikut, Sylejmonit iu besua udhëheqja e karvanëve nëpër bjeshkë e shtigje malesh për në Tropojë dhe të organizonte bashkërendimin e të ardhurve me strukturat vendore trojanë, në shërbim të tyre në vazhdimësi deri në çlirimin e Kosovës.

MISIONARI SYLEJMON PEPSHI NË TROPOJË

Sylejmon Pepshi në Tropojë ishte shtylla kryesore organizuese e bashkërenduese për mijëra të ardhur për gjithë veprimtarinë e tyre. Konkretisht disa nga vlerat e tij:

- Të ardhurit nga ShBA-ja, Evropa, që donin të luftonin për çlirimin e Kosovës, i drejtonte e i shoqëronte nëpër bazat ushtarake në Tropojë.
- Organizonte pritjen, ushqyerjen, sistemimin e popullsisë së ardhur nëpër shtëpitë trojane, institucionet vendore dhe në bazën e MCR-së në Mollë të Kuqe e në ish-repartet ushtarake.
- Bënte përcjelljet njerëzore në vendet në brendësi të Shqipërisë.
- Shoqëronte të sëmuret e të plagosurit që vinin nga fronti në spitalin e përbashkët civil-ushtarak të Tropojës dhe, sipas problematikave shëndetësore,



ndihmonte në përcjelljen me helikopter për në Tiranë.

- Bashkëpunonte me mediat vendore e të ardhura e nëpërmjet njerëzve ndihmonte për dhurim gjaku për nevojtarët e ardhur.
- Ndihmëtar për shpërndarjen e ndihmave ushqimore e materialeve jetësore.
- Veprimtar dinamik për ceremoniale mortore, varrosjes së luftëtarëve të UÇK-së dhe për çdo kosovar që

humbte jetën, ka hapur dyert mortore sipas riteve të duhura. Sylejmon Pepshi në bazë të aftësive dhe karakterit fitoi një popullaritet, sa që ndërhyrja e tij e pjekur ka zbutur e zgjidhur edhe ndonjë gjendje acaruese. Kur shkoja në Has, Kukës apo rajone të pacekura dhe më duhej përditësimi i gjendjes në Tropojë, “Baca” ishte një nga burimet e sakta si për numrin e të ardhurve, adresat e çdo gjë tjetër, sepse i ndiqte në vazhdimësi.

Në sintezë S. Pepshi ishte një Salli Bekeri (Sally Becker) junikas në Tropojë për hallet e ndryshme të fëmijëve, grave, pleqve, të shpëputurve nga trangu familjar, të sëmurve, të plagosurve, kufomave të luftëtarëve, të të vdekurve e shumëçka.

VLERËSIMET NDERUESE


Një pleqnar vendas veçonte: “Kur të nderojë me zemër e shpirt Tropoja do të thotë, se ai person ka shumë vlera”! Vërtet Sylejmoni ka merituar nderimet e Tropojës e më gjerë. Pas përfundimit të luftës, Këshilli Bashkiak “Bajram Curri” e falënderon S. Pepshin për të vijuar me mirënjohje dhe

tituj të ndryshëm, si nga autoriteti dhe llojshmëria; Organizata e Dëshmorëve të Atdheut, Unioni Artistik i Kombit Shqiptar dhe “Misionar i Kombit”, Organizata Kombëtare për Dëshmorët e LANÇ-it dhe “Nderi i Organizatës”, Drejtoria e Spitalit “B. Curri”, Shoqata Letrare Kulturore “Xheladin Gosturani” e tjera. Sylejmon Pepshi është certifikuar “Veteran Luftëtar” i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Këshilli bashkiak i qytetit i jep titullin “Qytetar Nderi” i Bashkisë Bajram Curri. Në ceremoninë e organizuar me fillim në Komunën e Junikut, e më pas në Potok, nga Bashkia e Komuna e Junikut, “Baca Sylejmon”, mes të tjerave, theksoi: “Zoti deshi që unë e bashkëshortja ime të mos kemi fëmijë. Bashkëshortja, një plakë e nderuar që u shurdhua nga pasojat e luftës. Por, sot Tropoja na bëri: me djalë, vajzë, nipa e mbesa. Jam borxhli i përjetshëm i Tropojës”!

Sylejmoni si njohës i aftë i vlerave zakonore të Tropojës, edhe pas misionit të tij fisnik, për çdo rast fatkeqësie është i pranishëm në çdo familje trojane.





QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

Tri humbjet e Llapit nuk e rrezikojnë karrigen e Batatinës

Pavarësisht se ende nuk e ka fituar asnjë pikë në edicionin 2020/2021, Tahir Batatina do të vazhdojë t'i prijë skuadrës së Llapit. Klubi nga Podujeva e ka mohuar se Orges Shehi do ta marrë drejtimin e skuadrës, ndërsa nga ky klub është larguar futbollisti i dëshmuar Erlis Ymeri



vërtetë në këtë drejtim”, thuhet në njoftimin e Llapit.

Kjo skuadër ka sqaruar edhe arsyen pse Shehu ishte i pranishëm në ndeshjen në mes të Llapit dhe Gjilanit. “Trajneri në fjalë, Orges Shehi, është e vërtetë se ishte në ndeshjen Llap - Ballkani, por jo në lidhje me angazhimin në shtabin teknik, por ishte në vëzhgim të të disa futbollistëve të rinj të klubit”,

thuhet në njoftimin e klubit llapjan.

KF Llap ka kërkuar nga mediat që çdo raportim që e bëjnë në lidhje me këtë klub ta marrin edhe informacionin zyrtar nga drejtuesit e klubit.

Futbollistët dhe trajnerin Tahir Batatina i pret edhe një sfidë mjaft e vështirë në fundjavë, pasi do të takohen në stadiumin “Fadil Vokrri” me skuadrën e

Prishtinës, e cila, po ashtu, pësoi humbje në ndeshjen e fundit. Futbollisti Erlis Ymeri është larguar nga skuadra e Llapit. Lajmin e ka konfirmuar vetë futbollisti në profilin e vet në “Facebook”. “Nuk jam më pjesë e ekipit të KF Llapit. Një periudhë që do të jetë gjatë në kujtesën time për sezonin e mirë që bëra dhe për mbështetjen maksimale që më kanë dhënë tifozët. Falënderime për stafin drejtues, presidencën e klubit, për të gjithë pjesëtarët që kam pasur mundësi të punoj në klub dhe kënaqësi që kam punuar me djem të mrekullueshëm. Ultras Legjendat dhe 1932 do të jeni gjithmonë në zemrën time, një tifozëri që shpresoj se shumë shpejt të shpërblehen me suksese. Shumë suksese në vazhdim KF Llapit”, thuhet në njoftimin e Llapit. Largimin e Ymerit e konfirmoi edhe klubi llapjan.

EPOKA E RE

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 1 TETOR - Skuadra e Llapit e nisi me ambicie të mëdha edicionin e ri 2020/2021 në Superligë, por në tri ndeshjet e para rezultatet e kësaj skuadre kanë qenë tejet negative, duke humbur të gjitha ndeshjet. Ndërsa ndeshjen që nuk e zhvilloi e kishte kundër kampiones në fuqi, Dritës. Humbja e pësuar të mërkurën nga Ballkani në stadiumin “Zahir Pajaziti” ka sjellë mjaft dyshime mbi të ardhmen e trajnerit Tahir Batatina, madje është folur për

angazhimin e trajnerit nga Shqipëria, Orges Shehu.

Klubi nga Podujeva ka reaguar lidhur me këta zëra, duke mohuar se drejtimin e klubit do ta marrë trajneri shqiptar Shehu. Pavarësisht prej rezultateve të fundit, duket se trajneri Tahir Batatina do të mbetet në krye të skuadrës të paktën edhe për disa xhiro. “Duke i parë raportimet në lidhje me pozicionin e trajnerit të KF Llapit, pra spekulimet dhe gënjeshttrat, kinse trajneri Orges Shehi do ta marrë drejtimin e klubit, reagojmë dhe mohojmë të gjitha këto shkrime dhe ju njoftojmë se nuk ka asgjë të

Drenica dhe Gjilani ndajnë pikët

SKENDERAJ, 1 TETOR (ER) - KF Drenica po tregohet i fortë në këtë edicion të Superligës. Kuqezinjtë, pas barazimit që morën me Feronikelin (2-2), të enjten arritën të fitojnë edhe një pikë mjaft të rëndësishme në përballje me Gjilanin (0-0). Është dashur të kalojë gjysmë ore lojë për t'u regjistruar rasti i parë serioz në ndeshje, kur nga gjuajtja e lirë provoi Veliu, por në vend ishte Arion Ymeri. Tentimin e Elshanit të vendësve e ndali portieri Koliçi, kurse

Ymeri ia mohoi golin Kurtajt dhe skuadrat shkuan në pushim me rezultatin 0-0. Në pjesën e dytë, Hajdari provoi të shënojë por, pa sukses, derisa zëvendësuesi Shend Kelmendi gjuajti jashtë portës. Kelmendi e pati edhe një rast të mirë shënimi që nuk arriti ta konkretizojë në gol. Ndeshja përfundoi 0-0. Pas kësaj xhironje, Drenica është në vendin e pestë me pesë pikë, kurse Gjilani zë vendin e gjashtë me pikë të njëjta me skuadrën kuqezi.



SUPERLIGA

Drenica - Gjilani	0-0
Llapi - Ballkani	1-3
Trepça '89 - Prishtina	1-0
Drita - Besa	3-1
Arbëria - Feronikeli	0-0

Tabela

		PIKË
1. Ballkani	4	10
2. Arbëria	4	8
3. Trepça '89	3	6
4. Feronikeli	4	5
5. Drenica	4	5
6. Gjilani	4	5
7. Prishtina	3	4
8. Drita	1	3
9. Llapi	3	0
10. Besa	4	0

Në xhiron e pestë takohen: Gjilani-Arbëria, Feronikeli-Drita, Ballkani-Drenica, Besa-Trepça '89, Prishtina-Llapi.

Ronaldo kundër Messit, Interi në grupin e 'ferrit'

GJENEVË, 1 TETOR - Rikthehet dueli epik Lionel Messi - Cristiano Ronaldo. Goglat e shortit të Ligës së Kampioneve, që është hedhur në Gjenevë të Zvicrës, kanë hedhur në një grup Barcelonën dhe Juventusin (Grupi G), që do të thotë se në këtë fazë do të ketë dy duele interesante mes dy lojtarëve që kanë fituar së bashku 11 Topa të Artë. E pabesueshme ajo që rezervon fati, sërish përballë njëri-tjetrit dy ikona të futbollit, ndoshta më të mirët e historisë, një duel gjigantësh që duket sikur nuk do të ketë fund. Duele mjaft interesante edhe në grupet e tjera, por sigurisht edhe fat për disa ekupe, si në rastin e



Real Madridit, që si ekip më të fortë në Gruin B ka Shakhtar Donjeck, por nga ana tjetër do të përballet edhe me Interin, ekipi më pak i dëshiruar nga vazoja e tretë.

Neuer, Kimmich, De Bryne dhe Lewandowski rëmbajnë çmimet

Janë zgjedhur futbollistët më të mirë të sezonit të fundit në kompeticionin më të rëndësishëm për klube, Ligën e Kampioneve. Sara Bouhaddi u shpall portierja më e mirë e sezonit të fundit. Francezja për herë të pestë radhazi fitoi trofeun e Ligës së Kampioneve për femra. Wendie Renard (kapitenia e Lyon) u përzgjedh mbrojtësja më e mirë, kurse mesfushorja më e mirë është zgjedhur Dzenifer Marozsan (Lyon). Sulmuesja më e mirë u shpall 27-vjeçarja daneze e

Chelseas, Pernille Harder. Kapiteni i Bayern Munchenit, Manuel Neuer, u zgjedh portieri më i mirë i sezonit të kaluar në Ligën e Kampioneve. Ndërsa shoku i skuadrës së Neuerit, Joshua Kimmich shpallet mbrojtësi më i

mirë i sezonit të fundit në garën më të fortë në futboll. Kevin De Bruyne i Manchester Cityt u shpall mesfushori më i mirë i sezonit të kaluar, kurse Robert Lewandowski është zgjedhur sulmuesi më i mirë.

GRUPI A	GRUPI C	GRUPI E	GRUPI G
Bayern Mynih Atletico Madrid Salzburg Lokomotiv Moskw	Porto Manchester City Olympiacos Marseille	Sevilla Chelsea Krasnodar Rennes	Juventus Barcelona Dinamo Kyiv Ferencváros
GRUPI B	GRUPI D	GRUPI F	GRUPI H
Real Madrid Shakhtar Inter Monchengladbach	Liverpool Ajax Atalanta Midtjylland	Zenit Dortmund Lazio Club Brugge	PSG Manchester United Leipzig Istanbul Basaksehir


Januzaj: Do të punoj fort për t'u kthyer sa më parë

Donostia-San Sebastian, 1 tetor - Mesfushori ofensiv shqiptar i Real Sociedadit, Adnan Januzaj, do të jetë jashtë fushave për disa javë, pas lëndimit që pësoi në

sfidën kundër Valentias, i cili u detyrua ta lërë fushën e lojës në minutën e 67-t. Klubi spanjoll ka njoftuar se Januzaj ka pësuar një dëmtim të shkallës së parë në

kofshën e këmbës së majtë. Real Sociedadit nuk ka treguar kohën e rikuperimit por, sipas mediave spanjolle, lëndime të tilla marrin kohë shërimi të paktën dy

deri në tri javë. “U zëvendësova për shkak të një lëndimi të martën, asgjë serioze. Do të punoj fort për t'u kthyer sa më parë”, ka thënë Januzaj.



Hysenagolli: Do të rris basketbollin shqiptar



PRISHTINË, 1 TETOR - Endrit Hysenagolli është një nga basketbollistët që ka luajtur në Kosovë dhe Shqipëri. Ai e mirëpret krijimin e Ligës Unike dhe e sheh si shumë pozitive për basketbollin mbarëshqiptar. Hysenagolli ka luajtur për Bashkimin dhe Pejën në Kosovë, kurse në Shqipëri luajti për Partizanin, Tiranën, Teutën, kurse tash është anëtar i Goga Basket. Qendra e Kombëtares Shqiptare në

një intervistë për faqen zyrtare të FBK-së ka folur për krijimin e Ligës Unike. “Krijimi i Ligës Unike, për mendimin tim, është një ide e shkëlqyer si në aspektin e rritjes së nivelit të basketbollit shqiptar, po ashtu edhe në bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Mendoj se është një mundësi e artë edhe për lojtarët e rinj si në Shqipëri, po ashtu në Kosovë, duke fituar përvojë nga kjo ligë, duke e ditur se skuadrat do të

jenë më të forta”, është shprehur Hysenagolli. Ai beson se do të rritet interesimi në të dy vendet. “Besoj se edhe interesimi do të jetë i madh si në Shqipëri, por edhe në Kosovë. Do të ishte një gjë shumë e bukur të luhej me tifozë me sallat plot, duke ditur që Kosova i ka sallat e zjarra, po besoj se edhe këtu (Shqipëri) do të ketë interesim të madh dhe palestrat do të mbushen”, ka thënë Endrit Hysenagolli.

Miami, ‘kafshatë’ e lehtë për Lakersat

Orlando, 1 tetor - Los Angeles Lakersi ka fituar finalen e parë kundër Miami Heatit me rezultatin 116-98 dhe ka treguar se llogaritë për ekipin kampion në NBA mund të mbyllën shumë shpejt. Sigurisht se Lakersat janë favoritë absolutë dhe Miami bëri disi rezistencë në periodën e parë, që u mbyll me rezultat 31-28. Në të dytën skuadra nga Kalifornia vendosi diktatin duke shënuar 14 pikë më shumë (34-20) dhe deri pas periodës së tretë diferenca shkoi në 27 pikë. Praktikiqisht ndeshje e mbyllur dhe Miami nuk mund ta bënte dot mrekullinë. Ata që spikatën në fushë ishin të zakonshmit, Anthony Davis dhe LeBron James. I pari vijon të shënojë më shumë se të gjithë dhe këtë herë regjistroi 34 pikë, veç pesë asistimeve dhe 9 topave të kapur në tabelë. “Mbreti”, për një asistim (realizoi 9) mund të kishte regjistruar një tjetër “triple double”, pasi shënoi 25 pikë dhe kapi 13 topa në tabelë. Jimmy



Butler, i vetëm për Miamin me 23 pikë, e kishte të pamundur ta udhëhiqte skuadrën e tij të surprizonte Lakersin.

SHKURT

Mulleri bëhet futbollisti më i trofeshëm në futbollin gjerman

Thomas Mulleri është bërë lojtari me më së shumti trofe të fituar në historinë e futbollit gjerman, pasi e fitoi Superkupën e Gjermanisë. 31-vjeçari i ka fituar nëntë tituj në Bundesligë, gjashtë trofe në Kupën e Gjermanisë DFB-Pokal, dy në Ligën e Kampionëve, një Kupë të Botës, një Kupë të Botës për klube, dy trofe në Superkupën e UEFA-s dhe gjashtë trofe në Superkupën e Gjermanisë.

Barça konfirmon transferimin e Destit

Skuadra e Barcelonës ka konfirmuar se e ka transferuar Sergino Dest nga Ajaxi. Futbollisti 19-vjeçar në “Camp Nou” vjen si zëvendësues i Nelson Semedos. Dest ka qenë dëshirë e Ronald Koeman, që këtë verë ka marrë drejtimin e skuadrës nga ‘Camp Nou’. Në faqen zyrtare të klubit të Barcelonës, i është uruar mirëseardhje talentit të ri. Dest ka zhvilluar edhe tri ndeshje për Kombëtaren e Amerikës.

Paqueta prezantohet te Lyoni

Mesfushori Lucas Paqueta është prezantuar te Lyoni. Futbollisti brazilian ka firmosur kontratë pesëvjeçare me klubin francez, ndërsa Lyoni ka paguar 20 milionë euro. 23-vjeçari ka luajtur 44 ndeshje me Milanin në të gjitha garat që nga transferimi nga Flamengo në vitin 2019.

Koronavirusi shtyn ndeshjen Genoa - Torino

Seria A ka vendosur ta shtyjë ndeshjen në mes të Genoas dhe Torino, pas kërkesës së klubit vendës. Kjo përballje ishte planifikuar të luhej të shtunën prej orës 18:00 dhe tani mbetet të mësohet se kur do të zhvillohet kjo sfidë e kampionatit italian. Shtyrja e ndeshjes ka krijuar precedent pasi, sipas protokollit, ndeshjet mund të luhen, mjafton që të mos jenë 13 lojtarë dhe një portier të infektuar me Covid-19. Këtë kusht Genoa e plotëson, por normalisht gara shtrembërohet nëse ata do të zbrisnin në fushë me 15 mungesa për shkak të koronavirusit. Klubet kështu do ta kenë mundësinë që vetëm një ndeshje të kërkojnë ta shtyjnë, nëse kanë dhjetë ose më shumë të infektuar në ekip.

Hague prezantohet te Milani

Jens Petter Hauge është prezantuar nga AC Milan. Sulmuesi anësor ka nënshkruar kontratë me skuadrën kuqezi për pesë vjetet e ardhshme dhe Milani ka paguar pesë milionë euro për kartonin e tij. “Sulmuesi norvegjez ka nënshkruar një kontratë deri më 30 qershor të vitit 2025. I lindur në Bodo (Norvegji) më 12 tetor të vitit 1999, Hauge u formua te të rinjtë e Bodo/Glimt para se të debutonte me ekipin e parë në vitin 2016. Në vitin 2018, pas 67 paraqitjeve dhe 9 golave me ekipin e qytetit të tij, ai u huazua te skuadra e Aalesundit për një sezon, para se të kthehej te Bodo/Glimt, ku ka shënuar 26 gola në 51 ndeshje gjatë dy sezoneve të fundit. Sulmuesi do ta veshë fanellën me numër 15”, thuhet në njoftimin e AC Milan.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtari në Këshillin Gjyqësor të Kosovës

Në pajtim me nenin 10 të Ligjit nr. 06/L -055 për Këshillin Gjyqësor të Republikës Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit kushtetues dhe ligjor për zgjedhjen e anëtarëve në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës,

Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:

Një (1) anëtar në Këshillin Gjyqësor, siç përcaktohet me nenin 108, paragrafi 6, nënparagrafi 4 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (Amendamenti nr. 25 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës), si dhe

Kandidati për anëtar në Këshillin Gjyqësor të Republikës së Kosovës, përveç kushteve të përcaktuara me Kushtetutë dhe me Ligjin për Këshillin Gjyqësor, duhet t'i plotësojë edhe këto kushte:

1. Kandidati që nuk ushtron funksionin e gjyqtarit, duhet të ketë së paku pesë (5 vite) përvojë pune profesionale dhe duhet të ketë njohuri për funksionimin e sistemit gjyqësor të Republikës së Kosovës;
2. Të ketë integritet të lartë moral;
3. Të mos jetë i dënuar për vepër penale në Kosovë;
4. Të mos ketë ushtruar ndonjë funksion politik në tri (3) vitet e fundit; (për kandidatet që nuk ushtrojnë funksionin e gjyqtarit).
- 5.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (për kandidatët që nuk ushtrojnë funksionin e avokatit apo gjyqtarit);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 16.10.2020, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. “Nëna Terezë” pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. “Nëna Terezë” pa nr. ose

Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Sudskog Saveta Kosova

Shodno članu 10. Zakona br. 06/L -055 o Sudskom savetu Republike Kosovo i u cilju ispunjenja ustavne i zakonske obaveze za izbor članova Sudskog saveta Republike Kosovo,

Skupština ponovo raspisuje konkurs za popunu pozicije:

Jednog (1) člana u Sudskom savetu, kako je utvrđeno u članu 108. Stav 6, pod-stav 4, Ustava Republike Kosovo (Amandman br. 25. Ustava Republike Kosovo),

Kandidat za člana Sudskog saveta Republike Kosovo, sem uslova utvrđenih Ustavom i Zakonom o Sudskom Savetu, treba ispuniti sledeće uslove:

1. Kandidat koji ne vrši funkciju sudije, treba imati najmanje pet (5.) godina profesionalnog radnog iskustva i treba imati znanja o funkcionisanju pravosudnog sistema Republike Kosovo;
2. Treba imati visok moralni integritet;
3. Da ne bude kažnjen za krivično delo na Kosovu;
4. Da nije vršio neku političku funkciju u poslednjih tri (3.) godina; (za kandidate koji ne vrše funkciju sudije).

Aplikaciji se treba priložiti sledeća prateća dokumentacija:

- Autobiografija (Curriculum vitae);
- Dokaz o školskoj i profesionalnoj pripremi (za kandidate koji ne vrše funkciju advokata ili sudije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosovo;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjen za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 16.10.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul.“Majka Tereza“ bb. ili u

Elektronskom obliku: internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.

Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažećim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e një (1) anëtari në Këshillin Prokurorial të Kosovës, përfaqësues nga shoqëria civile

Në pajtim me nenin 9 dhe 10 të Ligjit 06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe me qëllim të përmbushjes së obligimit ligjor për zgjedhjen e anëtarit në Këshillin Prokurorial të Kosovës,

Kuvendi rishpall konkurs për plotësimin e pozitës:

Një (1) anëtar, përfaqësues nga shoqëria civile.

- I. Kandidati për anëtar në Këshillin Prokurorial të Republikës së Kosovës, duhet t'i plotësojë këto kushte:
 1. Të jetë shtetas dhe banor i Republikës së Kosovës;
 2. Të ketë përgatitje të lartë profesionale nga fusha e drejtësisë;
 3. Të ketë njohuri nga fusha e të drejtave të njeriut;
 4. Të ketë përvojë pune në çështjet ligjore së paku 5 (pesë) vjet;
 5. Të ketë përkrahjen e së paku 5 (pesë) organizatave të shoqërisë civile të fushës së drejtësisë;
 6. Të mos jetë i dënuar për vepër penale.

II. Shoqëria civile duhet t'i bashkëngjisë listës së kandidatëve të nominuar për anëtar edhe dokumentet, të cilat vërtetojnë se kandidati i plotëson kushtet e paraqitura në këtë shpallje publike.

III. Kuvendi i Kosovës inkurajon shoqërinë civile, që gjatë dërgimit të propozimeve për anëtar të KPK-së, të marrë parasysh përbërjen shumetnike të Republikës së Kosovës dhe parimet e pranuar të barazisë gjinore.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Autobiografia (Curriculum vitae);
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale (diplomat nga universitetet jashtë vendit, duhet të jenë të nostrifikuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë);
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është i dënuar për vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 16.10.2020, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën: Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtoria e Personelit, Zyra N-217);

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org
Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonesë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor jednog (1) člana Tužilačkog saveta Kosova, predstavnik civilnog društva

Na osnovu člana 9. i 10. Zakona br. 06/L-056 o Tužilačkom savetu Kosova i u cilju ispunjavanja zakonske obaveze za izbor člana Tužilačkog saveta Kosova,

Skupština ponovo raspisuje konkurs za popunu pozicije:

Jedan (1) član, predstavnik civilnog društva.

- I. Kandidat za člana Tužilačkog saveta Republike Kosova, dužan je da ispuni sledeće uslove:
 1. Da je državljanin i stanovnik Republike Kosova;
 2. Da poseduje visoku stručnu spremu iz oblasti prava;
 3. Da poseduje znanje iz oblasti ljudskih prava;
 4. Da ima radno iskustvo o pravnim pitanjima, najmanje 5 (pet) godina;
 5. Da ima podršku najmanje 5 (pet) organizacija civilnog društva iz oblasti pravosuđa;
 6. Da nije kažnjavan za krivično delo.

II. Civilno društvo dužno je da priloži listi nominiranih kandidata za člana i dokumenta, koja dokazuju da kandidat ispunjava uslove navedene u ovom javnom konkursu.

III. Skupština Kosova podstiče civilno društvo da tokom dostavljanja predloga za člana TSK-a, uzme u obzir multietnički sastav Republike Kosova i priznata načela rodne ravnopravnosti.

Aplikaciji priložiti sledeća prateća dokumenta:

- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi (diplome Univerziteta van zemlje, moraju biti nostrifikovane od strane Ministarstva obrazovanja, nauke i tehnologije);
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 16.10.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu: Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. „Majka Tereza“ bb. ili u
Elektronskom obliku: internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta. Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Kuvendi i Republikës së Kosovës, rishpall:

KONKURS

Për zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore

Kuvendi i Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 4.8 të Ligjit nr.02/L-88 për Trashëgimi Kulturore, dhe me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kosovës për Trashëgimi Kulturore (KKTK), rishpall konkurs për zgjedhjen e shtatë (7) anëtarëve.

Përbërja e KKTK-së

KKTK përbëhet nga shtatë (7) anëtarë, të cilët zgjedhën për një mandat tre (3) vjeçar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, duke respektuar përbërjen etnike në Kosovë.

Funksionet e KKTK-së:

- Vlerëson dhe shpall trashëgiminë kulturore në mbrojtje të përhershme;
- Vlerëson të gjitha projektet e trashëgimisë kulturore të parashtruara nga institucionet e fushave përkatëse;
- Identifikon masat e domosdoshme të mbështetjes financiare për trashëgimi kulturore;
- Vlerëson të gjitha asetet më rastin e shpronësimit dhe shitblerjeve.

Kandidati/ja për t'u zgjedhur anëtar i KKTK-së duhet t'i plotësojë këto kushte:

- Të jetë shtetas dhe banor i përhershëm i Republikës së Kosovës;
- Të ketë etikë të lartë profesionale;
- Të ketë së paku diplomë universitare katër (4) vjeçare në fushën e trashëgimisë kulturore, fushës së arteve, arkeologjisë, arkitekturës, historisë, etnologjisë dhe antropologjisë kulturore;
- Të ketë së paku pesë (5) vite përvojë pune profesionale, kandidatët me përvojë pune në fushën e trashëgimisë kulturore kanë përparësi;
- Të jetë njohës i legjislacionit në fuqi për trashëgimi kulturore, si dhe konventave ndërkombëtare;
- Të mos jetë i dënues për vepër penale, të dënueshme mbi gjashtë (6) muaj,
- Njohja e gjuhëve të huaja është përparësi për kandidatët.

Mandati i anëtarëve të Këshillit

- Anëtarët e KKTK-së zgjedhën për mandat tre (3) vjeçar.

Aplikacionit duhet t'i bashkëngjiten këto dokumente përcjellëse:

- Aplikacionin;
- Autobiografia (Curriculum Vitae);
- Letër motivuese;
- Dy referenca,
- Dëshmia se është shtetas i Republikës së Kosovës;
- Dëshmia për përgatitjen shkollore dhe profesionale;
- Dëshmia për përvojën e punës;
- Dëshmia se nuk është nën hetime ose i dënues për ndonjë vepër penale.

PROCEDURA E KONKURIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen jo më vonë se deri më 16.10.2020, në orën 16:00.

Aplikacionet dërgohen personalisht ose me postë në adresën:
Ndërtesa e Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë (Rr. "Nëna Terezë" pa nr., Drejtorja e Personelit, Zyra N-217).

Aplikacionet mund të merren në këto vende:

Forma e shtypur: në recepcionin e ndërtesës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Prishtinë, rr. "Nëna Terezë" pa nr. ose
Forma elektronike: faqja e internetit e Kuvendit të Republikës së Kosovës www.assembly-kosova.org

Informata të tjera plotësuese mund të merren, çdo ditë pune deri në orën 16:00, në numrat e telefonit: 038/ 211-182, 038/ 211-648 dhe 044/ 567-041.

Aplikacioni duhet të dorëzohet së bashku me dokumentet e kërkuara.

Përdorimi i aplikacionit të gabueshëm dhe të pakompletuar me të dhënat e kërkuara dhe me të dhëna të paraqitura me vonë, konsiderohet i pavlefshëm.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Skupština Republike Kosovo ponovo raspisuje:

KONKURS

Za izbor sedam (7) članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe

Skupština Republike Kosovo, na osnovu člana 4.8 Zakona br. 02/L-88 o Kulturnom nasleđu i u cilju ispunjavanja zakonskih obaveza za izbor članova Saveta Kosova za kulturno nasleđe (SKKN), ponovo raspisuje konkurs za izbor sedam (7) članova.

Sastav SKKN

SKKN je u sastavu od sedam (7) članova, koji se biraju sa mandatom od 3 godine od strane Skupštine Republike Kosovo, poštujući etnički sastav na Kosovu.

Funkcija SKKN:

- Ocenjuje i objavljuje kulturno nasleđe u stalnoj zaštiti;
- Ocenjuje sve projekte kulturnog nasleđa, koje podnose institucije dotičnih oblasti;
- Identifikuje neophodne mere finansijske podrške za kulturno nasleđe;
- Ocenjuje sve asete, prilikom eksproprijacije i kupoprodaje.

Kandidat za izbor člana SKKN dužan je da ispuni sledeće uslove:

- Da bude državljanin i stalni stanovnik Republike Kosova;
- Da poseduje visoku profesionalnu etiku;
- Da ima najmanje 4-godišnju univerzitetsku diplomu u oblasti kulturnog nasleđa, oblasti umetnosti, arheologije, arhitekture, istorije, etnologije i kulturne antropologije;
- Da ima najmanje pet (5) godina profesionalnog radnog iskustva, prednost imaju kandidati sa radnim iskustvom u oblasti kulturne nasleđa;
- Da je poznavalac zakonodavstva na snazi o kulturnom nasleđu, kao i međunarodnih konvencija;
- Da nije kažnjavan za krivično delo, kažnjivo više od 6 meseci;
- Poznavanje stranih jezika je prednost.

Mandat članova Saveta

- Članovi SKKN biraju se sa mandatom od 3(tri) godine.

Aplikaciji mora da se prilože sledeći prateći dokumenti:

- Aplikacija;
- Autobiografija (Curriculum Vitae);
- Motivaciono pismo;
- Dve reference;
- Dokaz da je državljanin Republike Kosova;
- Dokaz o školskoj i stručnoj spremi;
- Dokaz o radnom iskustvu;
- Dokaz da nije pod istragom ili kažnjavan za krivično delo.

PROCEDURA KONKURISANJA

Aplikacije se dostavljaju najkasnije do 16.10.2020. godine u 16:00 časova.

Aplikacije se dostavljaju lično ili putem pošte, na adresu:
Zgrada Skupštine Republike Kosova, Priština (Ul. „Majka Tereza“ bb., Direkcija osoblja, Kancelarija N-217).

Aplikacije se mogu uzeti u ova mesta:

Štampana forma: u recepciji Zgrade Skupštine Republike Kosova, Priština, ul. "Majka Tereza" bb. ili u
Elektronskom obliku: internet–stranica Skupštine Republike Kosova - www.assembly-kosova.org

Ostale dopunske informacije mogu se dobiti svakog radnog dana u 16:00 časova, na brojeve telefona: 038/211-182, 038/ 211-648 i 044/ 567-041.

Aplikaciju treba dostaviti uz tražena dokumenta.
Korišćenje pogrešne, ili aplikacije koja nije kompletirana sa traženim podacima, kao i podaci dostavljeni sa zakašnjenjem, smatraju se nevažecim.

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

DREJTORIA E ARSIMIT
05nr.1544 datë 01.10.2020

Në bazë të nenit 8 të Ligjit të punës nr.03/L-212, nenit 35 të Ligjit për arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës me nr. 04/L-032, nenit 5 të Ligjit për arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës, nr.03/L-068, UA nr.10/2018 (Normativit mbi kuadrin profesional të arsimit të përgjithshëm), UA nr.05/2015 (Normativit për mësimdhënësit e arsimit profesional), Udhëzimit administrativ nr.07/2017 për rregullimin e procedurave për themelimin e mardhënies së punës në sektorin publik, Drejtoria Komunale e Arsimit rishpall këtë:

KONKURS

Për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2020/2021

- SHFMU "Migjeni" në Gjinoc**
Vendi i punës :Një punëtor teknik/ndihmës
Kualifikimi: Shkolla mesme
Paga mujore: Koeficienti 4
- SHFMU "Dituria" në Samadrexhë**
Vendi i punës :Një punëtor teknik/ndihmës
Kualifikimi : Shkolla mesme
Paga mujore: Koeficienti 4

Kushtet: Për të gjitha vendet e lira të punës të shpallura në konkurs kërkohet përgatitja adekuate profesionale sipas normativit UA nr.07/2017.

Dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim:

- Formulari i aplikimit (kërkesa) të cilën e plotëson kandidati
- Diploma e shkallës së kualifikimit ose certifikata në vend të diplomës e cila nuk duhet të jetë më e vjetër se gjashtë muaj (fotokopje) e vertetuar tek noteri.
- Ekstrakti i lindjes
- Letërnjoftimin (fotokopje)
- Dëshmia e përvojës së punës (nëse ka)

Dokumentet e kompletuara dorëzohen të fotokopjuara, ndërsa dokumentet origjinale prezantohen në intervistë. Dokumentet e pakompletuara dhe ato që arrijnë pas afatit nuk merren në shqyrtim nga komisioni. Aplikacionet merren dhe dorëzohen në Zyren Pritëse në Komunën e Suharekës. Afati i konkurrit 8 (tetë) ditë nga dita e publikimit të konkursit në gazetë.

Për orarin e intervistimit do të informoheni në faqen zyrtare të Komunës së Suharekës dhe tabelën e shpalljeve të DKA-së.

Drejtoria DKA-së
Remzi Bajselmani

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO KOMUNA E SUHAREKËS OPSTINE SUVA REKA MUNICIPALITY OF SUHAREKA	
---	--	---

DIREKCIJA ZA OBRAZOVANJE
05 br.1544 od 01.10.2020 godine

Na osnovu člana 8 Zakona o radu br.03 / L-212, člana 35 Zakona o preduniverzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br. 04 / L-032, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br. 03 / L-068, AI br.10 / 2018 (Normativa o stručnim kadrovima opšteg obrazovanja), AU br.05 / 2015 (Normativa za nastavnike stručnog obrazovanja), Administrativnog uputstva br.07 / 2017 o regulisanju procedura za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Opštinska direkcija za obrazovanje objavljuje sledeće:

KONKURS

Za popunu slobodnih radnih mesta za školsku godinu 2020/2021

- ONSS „Migjeni“ u Dinovce**
Radno mesto: jedan tehnički / pomoćni radnik
Kvalifikacija: Srednja škola
Mesečna plata: Koeficijent 4
- ONSS "Dituria" u Samadreu**
Radno mesto: Jedan tehnički / pomoćni radnik
Kvalifikacija: Srednja škola
Mesečna plata: Koeficijenti 4

Uслови: -Za ova slobodna radna mesta objavljena na konkursu potrebna je odgovarajuća stručna sprema prema normative AU br.07/2017.

Dokumentacija potrebna za konkurs:

- Obrazac (prijava) koji kandidat popunjava
- Diploma ili potvrda stepena stručne spreme umesto diplome, koja ne sme biti starija od šest meseci (fotokopija).
- Izvod rođenja
- Lična karta (fotokopija)
- Dokaz o radnom iskustvu u obrazovanju (ako ga ima)
- Potvrda za obuke akreditovane od MONT-a (ako ga ima)

Kompletna dokumenta se dostavljaju fotokopirana, dok se originalna dokumenta predstavljaju na intervjuu.

Nepotpune dokumente i one koji stignu posle roka, komisija ne razmatra. Prijave se primaju i predaju u prijemnoj kancelariji u opštini Suva Reka.

Rok za konkurs 8(osam) dana od dana objavljivanja konkursa u novinama.

O rasporedu intervjuja biće obavesteni na zvaničnoj veb stranici opštine Suva Reka i na oglasnoj tabli ODO.

Direktor ODO
Remzi Bajselmani

**Premium Park Hotel Sh.p.k me
numër UNIK të biznesit:
811355545 dhe numrin e TVSh:
330432196 me seli në Prizren, ka
vendosur të bëjë zvogëlimin e
kapitalit nga shuma 20.000.000.00
në shumë 10.000, Prizren.**

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Gëzim Bytyqi shpall të pavlefshëm dëftesat e klasës së -X- dhe -IX- të shkollës Sh.M.L.P. "Shtjefan Gjeqovi" Prishtinë.
- Art Rudi shpall te pa vlefshme dëftesat e kl. X,XI,XII, diplomën dhe certifikatën e testit maturës Gjinnazit "Hajdar Dushi" ne Gjakovë.
- "Supertex American Style" Sh.p.k. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me numër: 330403692.
- Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.
- Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.
- Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepe shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.
- Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.
- Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 €uro. Tel: 044-185-233.
- Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.
- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.
- Urgjentisht kërkoj një banesë me qera ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188
- Lëshoj lokalim me qira. Lokali është i pasitur me të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275
- Lëshoj banesë me qira në lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.
- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.
- Lëshoj banesën e re me qera në qendër prapa teatrit Kombëtar, me sipërfaqe prej: 60 m2. Banesa ka një dhomë gjumi, sallon dhe kuzhinë. Ka të gjitha pajisjet. Çmimi: 300 €uro. Banesa lëshohet për afate të gjata dhe të shkurtra. Informata në tel: 049\44-888-801 (viber)

**Kërkoj një pastruese për shtëpi. Shtëpi është në Prishtinë.
Çmimi sipas marrëveshjes. Informatat në tel: 045-336-731**





ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

